



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

MINISTRY FOR DIALOGUE

---

# **RAPORT MBI GJENDJEN NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT**

16 qershor – 25 nëntor 2016

---

**RAPORTI I DORËZUAR NË BASHKIMIN EVROPIAN/SHËRBIMIN EVROPIAN PËR  
VEPRIM TË JASHTËM**

**NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Prishtinë, 25 nëntor 2016

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport vlerësues mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun e Brukselit është i dyti me radhë për këtë vit dhe përfshinë periudhën nga 16 qershori deri më 25 nëntor 2016.

Raporti paraqet vlerësimin zyrtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi progresin dhe sfidat në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në Dialogun e Brukselit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraqitur rregullisht raportet e vlerësimit mbi zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që nga viti 2011 kur ka filluar ky dialog. Ky është raport i dytë me radhë për këtë vit kalendarik. Qëllimi ynë është që të ofrojmë pikëpamjet dhe rekomandimet tona se si të bëhet ky dialog më i suksesshëm. Ne gjithmonë besojmë se 'fjalët duhet të përcillen me veprime'. Për këtë arsye ne konsiderojmë se zbatimi konsekuent dhe efektiv i marrëveshjeve nga të gjitha palët është me rëndësi për të pasur sukses.

Qeveria e Republikës së Kosovës i jep rëndësi të madhe dialogut të lehtësuar nga BE, sepse kjo kontribuon në normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në rrugën e Kosovës drejt integritit evropian. Po ashtu, me rëndësi të njëjtë është edhe ndihma që po i ofrohet ri-integritit të komunitetit serb në sistemin e Kosovës, duke i dhënë fund strukturave paralele të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës.

Performanca konstruktive e Kosovës në Dialogun e Brukselit ka kontribuar në integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Në tetor të vitit 2015, është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në e cila ka hyrë në fuqi në muajin prill, dhe Kosova filloi zyrtarisht rrugëtimin e saj drejt integritit në BE. Kjo është një arritje e madhe e cila konfirmon suksesin e Kosovës në përmbushjen e standardeve të kërkuara evropiane përderisa pranojmë më shumë përgjegjësi dhe motiv më të lartë për të shtyrë përpara reformat evropiane në vendin tonë.

Qeveria e Kosovës konsideron se dialogu ka sjell arritje të konsiderueshme duke pasur parasysh se janë arritur dhe zbatuar shumë marrëveshje nga të dyja palët që nga viti 2011 kur filloi ky dialog. Pa dyshim, faktor kyç për të ndihmuar këtë sukses është përfshirja dhe lehtësimi i Bashkimit Evropian/Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm si dhe mbështetja e vazhdueshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania dhe vende tjera të BE-së.

Qeveria e Kosovës ka qenë dhe mbetet një palë konstruktive dhe serioze në dialog. Ne kemi bërë çdo përpjekje të mundshme në arritjen e marrëveshjeve dhe qëndrimin konsistent duke realizuar ato për çka jemi pajtuar. Parimi kryesor që na udhëheq është bindja se dialogu mund të ndihmoj për të transformuar marrëdhëniet armiqësore në marrëdhënie paqësore fqinjësore, për të cilën faktor qenësor është njohja e ndërsjellë mes dyja shteteve, Kosovës dhe Serbisë.

Megjithatë, procesi i zbatimit të marrëveshjeve të arritura është përballur me vonesa, evazione apo shkelje nga ana e Serbisë. Fenomeni më shqetësues është dualizmi i Serbisë në zbatim që do të thotë se në njërin anë ajo zbaton marrëveshjet dhe në anën tjetër vazhdon të mbështesë strukturat e saj paralele në Kosovë.

Kohëve të fundit, pas një viti të bllokadës nga ana e Serbisë, gjendja aktuale sa i përket zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit është më tepër inkurajuese në këtë periudhë, në krahasim me periudhën e kaluar, e cila tingëllon pesimiste për shkak të ndalimit të zbatimit të marrëveshjeve të rëndësishme që rrjedhin nga pakoja e marrëveshjeve e datës 25 gusht 2015.

Pakoja e marrëveshjeve e 25 gushtit 2015 trajtoi katër çështje: telekomin/kodin shtetëror të Kosovës, energjinë/funksionimin e pavarur të KOSTT-it, heqjen e barrikadës nga Ura e Mitrovicës dhe Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Pas më shumë se një viti, përfundimisht më 14 gusht të vitit 2016 filloi zbatimi me largimin e barrikadës nga ura përderisa rivitalizimi i saj është në progres e sipër dhe pritet të finalizohet më 20 janar 2017. Kjo urë ka qenë një urë e ndarjes që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999 dhe tani më do të jetë si çdo urë tjetër në botë duke shërbyer në lidhjen e njerëzve dhe sigurimin e lëvizjes së plotë të lirë për njerëzit dhe automjetet.

Një tjetër marrëveshje që është në proces të zbatimit është marrëveshja për kodin shtetëror të Kosovës. Bazuar në marrëveshjet e rëndësishme, konkluzionet e pajtuara më 13 nëntor 2016 dhe 18 nëntor 2016, Kosovës do t'i ndahet kodi telefonik nga ITU-ja më 15 dhjetor 2016. Kjo gjithashtu do të thotë se Kosova në të njëjtën kohë do të sigurojë një licencë për operim të përkohshëm dhe të kufizuar për telefoninë mobile dhe licencë të plotë për telefoninë fikse për një kompani të re të regjistruar në Kosovë, në pajtim me ligjin e Kosovës. Në përputhje me marrëveshjen e vitit 2013 mbi telekomin dhe me planin e veprimit të vitit 2015, më 3 dhjetor 2016, Serbia do të dërgojë letër tek ITU duke u dakorduar për kodin e thirrjes për Kosovën. Bazuar në këtë marrëveshje, Austria ka aplikuar në ITU për të kërkuar ndarjen e kodit për Kosovën, në janar të këtij viti. Vlen të theksohet se negociatat mbi marrëveshjen e telekomit/kodit shtetëror të Kosovës kanë zgjatur rreth gjashtë vite me shpresë që 15 dhjetori i vitit 2016 do t'i sjellë Kosovës kodin e vet ndërkombëtar të thirrjes.

Nga ana tjetër, Marrëveshja për energjinë e vitit 2013 dhe Plani i Veprimit i vitit 2014, i cili parasheh që sistemi i transmissioinit të energjisë së Kosovës (KOSTT) të operojë në mënyrë të pavarur në përputhje me ENTSO-E, mbetet i bllokuar nga Serbia. Marrëveshja e rëndësishme për këtë çështje, si pjesë e pakos së marrëveshjeve të datës 25 gusht 2015, ka bërë të qartë edhe një herë se KOSTT do të veprojë në mënyrë të pavarur. Marrëveshja në mes të KOSTT dhe ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmissioinit) është arritur më 1 tetor 2015, por zbatimi nuk ka mundur të fillojë për shkak të bllokadës nga ana e Serbisë. Ne shpresojmë se progresi i mirë në dy marrëveshjet e përmendura më lartë sinjalizon gatishmërinë e mundshme të palës serbe për zbatimin e kësaj marrëveshje, e cila do t'i japë fund negociatave gjashtë vjeçare për këtë çështje.

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjes mbi Asociacionin, siç kemi treguar në të gjitha marrëveshjet tjera. Procesi i hartimit të statutit do të filloj në Prishtinë menjëherë pasi që Kosova të fitojë kodin e saj telefonik nga ITU, më 15 dhjetor 2016. Ky proces do shkojë paralelisht me heqjen e strukturave të mbetura paralele të Serbisë në Kosovë, për të cilat në Bruksel do të filloj punën grupi trepalësh.

Marrëveshja për Asociacionin e arritur më 25 gusht 2015 është në përputhje me Ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës, prandaj Asociacioni nuk do të ketë ndonjë kompetencë ekzekutive dhe nuk do të jetë një shtresë e tretë e qeverisjes në Kosovë. Siç parashihet në pikën 2 të kësaj Marrëveshjeje, kjo marrëveshje është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kështu që statuti i Asociacionit do të jetë në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 26 dhjetor 2016. Në mënyrë që të shfaq seriozitetin për zbatimin e Asociacionit, në qershor të këtij viti, Kosova ka bërë një hap përpara duke ndryshuar përbërjen e Ekipit Menaxhues të themeluar në vitin 2013, me emërimin e dy anëtarëve të rinj, meqë ish anëtarët kanë kaluar në detyra tjera.

Më 14 shtator 2016, u arrit një marrëveshje e rëndësishme për reciprocitetin në targa mes Kosovës dhe Serbisë, duke i dhënë fund targave "të përkohshme - prova" që pala serbe ka aplikuar në mënyrë të njëanshme për targat RKS të Kosovës që nga viti 2011. Kjo marrëveshje e njohur si "Marrëveshjet për kompletimin e zbatimit të Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë të vitit 2011" ka vendosur reciprocitetin në targa mes dy shteteve, duke filluar më 15 nëntor 2016 parasheh përfundimin e targave ilegale në 12 muaj, duke filluar nga 17 janari i vitit 2017 dhe zgjat periudhën e targave KS për 5 vjet. Afati i zbatimit është shtyrë për shkak të vonesave të natyrës administrative nga ana e Kosovës.

Në ndërkohë, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në zbatimin e marrëveshjeve tjera në fushat e mëposhtme: në fushën e drejtësisë, Kosova është duke përmbyllur procesin e zbatimit të marrëveshjes së Brukselit për drejtësi.

Në pajtim me ligjin e Kosovës, ne po themelojmë një gjykatë themelore dhe një zyrë prokuroriale në rajonin e Mitrovicës, që mbulon shtatë komunat. Ne kemi përfunduar integrimin/rekrutimin e stafit serb gjyqësor, 44 gjyqtarë, 34 prokurorë dhe 148 persona në stafin administrativ. Ka përfunduar provimi i jurisprudencës për 6 kandidatët. Nënshkrimi i deklaratave dhe betimi para Presidentit të Republikës së Kosovës nga ana e stafit të integruar gjyqësor do të realizohet së shpejti.

Ndërkohë, pala serbe duhet të ndërpresë mandatin dhe pagat për këta persona si dhe të shfuqizojë strukturat paralele të drejtësisë, duke ndryshuar ligjet e saj përkatëse.

Lidhur me Marrëveshjen për shuarjen e të ashtuquajturës mbrojtje civile (MC), zbatimi është pothuajse i përfunduar. Tashmë është shuar “Mbrojtja Civile”, ndërsa ish pjesëtarët e sajë (483 persona) janë integruar/punësuar në institucionet qendrore të Kosovës (22 institucione dhe agjenci). Aktualisht jemi duke bërë përgatitjet e fundit teknike të zyrave për këto institucione në katër komunat veriore të Kosovës, që do të përfundojnë gjatë këtij dhjetori. Serbia ka ndërprerë pagat për këta persona, ndërsa dorëzimi i hapësirave të MC-së në institucionet e Kosovës po vonon.

Kosova ka shënuar progres në krijimin e zyrave të Agjencisë Kosovare të Regjistrimit Civil (ARCK) dhe Gjendjes Civile në katër komunat veriore.

Këto zyra do të fillojnë funksionimin në së shpejti për dhënien e dokumenteve të shtetësisë dhe të gjendjes civile për qytetarët në veri, për të cilat kërkesat janë në rritje. Ish stafi administrativ i policisë është duke u integruar/rekrutuar në këto zyra. Trajnimi i stafit të integruar është kryer nga ARCK, ndërsa trajnimi i stafit për zyrat e gjendjes civile do të realizohet. Kosova do të zgjidh çështjen e vlefshmërisë së dokumenteve të vjetra, që do t’i mundësonin qytetarëve të marrin dokumentet e shtetit të Kosovës. Të dyja palët rikonfirmuan zotimet për zbatimin e marrëveshjeve për përfundimin e zbatimit të Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë të vitit 2011, të arritur në Bruksel, më 14 shtator 2016.

Sa i takon Marrëveshjes së IBM (MIK), përkatësisht për ndërtimin e objekteve të përhershme të MIK, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në përfundimin e dizajnit final të projekteve në bashkëpunim me BE-në dhe UNOPS-in si partner implementues. Më 14 shtator të vitit 2016, Qeveria e Kosovës aprovoi dizajnet finale të projekteve për vendkalimet kufitare në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë, për të cilat shteti ynë është pala mikpritëse. Afati i pajtuar për fillimin e punëve ndërtimore në të tri vendkalimet kufitare është paraparë për janar 2017. Ministria për dialog së bashku me institucionet përkatëse qeveritare, zyrën e PSBE-së në Kosovë dhe UNOPS-in janë duke punuar intensivisht në këto projekte, të cilat janë të financuara nga BE-ja.

Konstatojmë me shqetësim, se ekzistojnë dy marrëveshje të vitit 2011 të cilat ende janë në pritje të zbatimit.

Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave e cila ka ngecur nga Serbia deri në janar të vitit 2016, kur u arrit një marrëveshje me një fushëveprim më të gjerë duke përfshirë diplomat e të gjitha niveleve arsimore, dhe përgatitjet për zbatimin e saj janë në proces e sipër.

Marrëveshja për kthimin e dokumenteve kadastrale nga Serbia në Kosovë, ka ngecur nga ana e Kosovës për shkak të vonësave në miratimin e Ligjit për agjencinë teknike për krahasimin dhe verifikimin e dokumenteve kadastrale të kthyer nga Serbia. Kosova ka miratuar Ligjin në prill të këtij viti dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar kushtetutshmërinë e saj. Procesi i zbatimit do të fillojë së shpejti.

Qeveria e Kosovës vlerëson zhvillimet inkurajuese në procesin e zbatimit gjatë kësaj periudhe, ndërsa bën thirrje për më shumë përparim në të ardhmen. Dëshirojmë të theksojmë se për procesin e zbatimit efektiv, BE-ja mbetet një faktor qenësor për të ndihmuar përsheptimin dhe sigurimin e një konsistence në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit.

Sinqerisht,



**Edita Tahiri**  
Ministre për Dialog  
Kryenegociatore në Dialogun e Brukselit

## *Përmbajtja*

---

Përmbledhje ekzekutive	2
1. Telekomuni - Kodi shtetëror për Kosovën	8
2. Energjia - Operimi i pavarur i KOSTT-it	9
3. Largimi i barrikadës dhe revitalizimi i Urës së Mitrovicës	10
4. Përmirësime në funksionimin e katër komunave veriore në Kosovë	12
5. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë - akoma nuk janë shpërbërë	14
6. Asociacioni i komunave me shumicë Serbe në Kosovë	15
7. "Mbrojtja Civile" - Shpërbërja dhe integrimi i personelit në institucionet e Kosovës	16
8. Themelimi i Zyrave të Agjencisë për Regjistrim Civil dhe Zyrave të Gjendjes Civile në komunat veriore	17
9. Drejtësia	18
10. Zyrat ndërlidhëse dhe vizitat bilaterale	20
11. Tregtia e Lirë / Dogana	21
12. Liria e Lëvizjes	21
13. Reciprociteti në tabelat e automjeteve dhe ndalimi i tabelave të përkohshme të imponuara nga Serbia	22
14. MIK - Menaxhimi i integruar i kufirit dhe ndërtimi i objekteve të përhershme	22
15. Bashkëpunimi rajonal	23
16. Fondi zhvillimor	25
17. Mbledhja e të hyrave doganore në dy pikë-kalime kufitare në veri	25
18. Diplomati dhe kadastri	26
19. Sigurimi i automjeteve	26
Lista e shkurtesave	

## GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE

### 1. TELEKOMI – KODI SHETËTOR PËR KOSOVËN

---

Më në fund pas pothuajse gjashtë viteve negociata dhe tri viteve që nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Telekomin në Bruksel, marrëveshja për kodin shtetëror të Kosovës është në zbatim e sipër.

Sipas marrëveshjeve, përkatësisht përfundimeve të dakorduara më 13 nëntor 2016 dhe 18 nëntor 2016, ITU do t'ia ndajë Kosovës kodin telefonik më 15 dhjetor 2016.

Kjo gjithashtu do të nënkuptojë që Kosova do të ofrojë një licencë për operim të përkohshëm dhe të kufizuar në telefoninë mobile dhe licencë të plotë për telefoninë fikse për një kompani të re të regjistruar në Kosovë në përputhje me ligjin e Kosovës. Kjo kompani e re (mts d.o.o) do të operojë në zona të caktuara të Kosovës (në 30 lokacione). Licenca e përkohshme do të skadojë pas lëshimit nga autoritetet e Kosovës të një licence të plotë të pakufizuar të telefonisë mobile përmes një tenderi/ankandi ndërkombëtar.

Serbia do të dërgojë një letër tek ITU më 3 dhjetor 2016 duke u dakorduar për kodin telefonik për Kosovën, në përputhje me Marrëveshjen për Telekomin të vitit 2013 dhe Planin e Veprimit të vitit 2015.

Në bazë të kësaj marrëveshje, Austria ka aplikuar tek ITU dhe ka kërkuar ndarjen e kodit telefonik për Kosovën, në janar të këtij viti.

Kosova do të bashkëpunojë drejtpërdrejtë me ITU mbi zbatimin e kodit shtetëror dhe do të administrojë në mënyrë të pavarur kodin e saj si të gjitha shtetet tjera. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është autoriteti implementues në përputhje me ligjin e Kosovës.

Marrëveshja për Telekomin përcakton që pas zbatimit të kodit shtetëror 383, pas periudhës tranzitore, të gjitha kodet tjera ekzistuese në Kosovë, përkatësisht 381, 377 dhe 386, nuk do të ekzistojnë më.

Veprimtaria e operatorëve ilegal të Serbisë të telefonisë mobile dhe fikse në Kosovë do të ndërpritet pas 17 viteve të operimit ilegal që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Thirrjet nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas do të jenë thirrje ndërkombëtare.

Sinjali ndërkufitar i telefonisë mobile i Serbisë/Telecom Serbia do të largohet në mënyrë që të mos



mbulojë qëllimisht kufirin me Kosovën.

Do të vendoset kufiri i frekuencës ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rregullatorët e të dyja shteteve do të dakordohen për marrëveshjet teknike për harmonizimin e spektrit për GSM dhe sinjalit televiziv, përfshirë transmetimit territorial me qëllim të sigurimit të ofrimit të ndërsjellë të pandërprerë të shërbimeve në bazë të parimeve të ITU dhe shmangies së interferencave të dëmshme ndërmjet shërbimeve. Vendosja e një kufiri të frekuencave do t'i mundësojë Kosovës të zhvillojë programin e saj shtetëror të digjitalizimit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Takimi i parë për këtë qëllim do të mbahet para datës 3 dhjetor 2016 me qëllim të finalizimit të të gjitha marrëveshjeve në harmoni me afatin kohor të ofruar në 2.0 sipas planit të përditësuar mekanikisht të veprimit.

Do të ketë edhe marrëveshje për roaming dhe interkoneksion ndërmjet dy vendeve, përkatësisht ndërmjet operatorëve mobil të të dyjave shteteve.

## **2. ENERGJIA – OPERIMI I KOSTT SI OST I PAVARUR**

---

Marrëveshja e vitit 2013 për Energjinë dhe Plani i Veprimit i vitit 2014, i cili parasheh operimin e pavarur të sistemit të transmisionit të energjisë të Kosovës (KOSTT) është akoma e bllokuar nga Serbia.

Marrëveshja shtesë, si pjesë e pakos së marrëveshjeve të datës 25 gusht 2015, e ka bërë përsëri të qartë që KOSTT do të operojë në mënyrë të pavarur; megjithatë, akoma nuk ka ndonjë përparim në zbatimin e marrëveshjes për energjinë.

Hapi i parë i zbatimit, përkatësisht marrëveshja ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit) është arritur më datën 1 tetor 2015. Megjithatë, zbatimi mund të mos fillojë pasi që Serbia nuk ka vullnet politik për zbatimin e marrëveshjes. Serbia akoma nuk ka lejuar regjistrimin e një kompanie të re furnizuese në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës, përkundër faktit që Marrëveshja për Energjinë e vitit 2013, pika 4, përcakton që një kompani e re do të regjistrohet dhe do të operojë në përputhje me ligjin e Kosovës dhe kornizën rregullative.

Shpresojmë që progresi i mirë në Marrëveshjen për Telekomin do të sinjalizojë gatishmërinë e mundshme të Serbisë për zbatimin e kësaj marrëveshje, e cila do të sjellë përfundimin e negociatave gjashtë vjeçare mbi këtë çështje.

Dështimi i Serbisë në zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Energjinë madje ka ndikim më të gjerë negativ. Si pasojë, linja e interkoneksionit prej 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë nuk ka filluar akoma për shkak të faktit që KOSTT *de facto* është i bllokuar që të operojë në mënyrë të pavarur, edhe pse *de jure* është një OST i pavarur duke e pasur parasysh që ka

nënshkruar marrëveshjen me ENTSO-E. Samiti i Parisit i mbajtur më 5 korrik 2016 mbi zbatimin e WB6 ka nxjerrë këtë përfundim: Çdo OST duhet të lejojë Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT) që të lidhet me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E) dhe të ndajë kapacitete në interkonektorët e tij me vendet fqinje në përputhje me Marrëveshjen e Koneksionit të nënshkruar me ENTSO-E. Për më tepër, dështimi i Serbisë në zbatimin është duke paraqitur pengesa në bashkëpunimin rajonal në fushën e infrastrukturës, veçanërisht në iniciativën Western Balkans Six që *ndër të tjera* bën thirrje për konektivitet rajonal në sektorin e energjisë elektrike.

Kosova rregullisht ka shprehur shqetësime për këtë çështje me zyrtarët e BE-së dhe partnerët ndërkombëtar duke kërkuar më shumë presion për Serbinë për zbatimin e marrëveshjes për energjinë. Në takime të ndryshme me Komunitetin për Energji, ENTSO-E dhe të tjerët, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës kanë kërkuar zgjidhje për çështjen.

Në mbështetje të gjetjes së zgjidhjes, Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë në takimin e mbajtur më 14 tetor 2016, pas ankesës nga KOSTT kundër Serbisë mbi rastin ECS- 3/2008, është konfirmuar që Serbia ka shkelur Traktatin mbi Themelimin e Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore, përkatësisht nenin 6 të Rregullores së KE 1228/2003 në lidhje me Kosovën. Ata kanë përcaktuar datën 31 dhjetor 2016 si afatin e fundit për Serbinë që të zgjidh këtë çështje.

Takimi i nivelit të lartë të ENTSO-E dhe OST-ve të EJL më 2-3 nëntor 2016 në Selanik erdhi në përfundim që mos zbatimi i marrëveshjes për lidhje ndërmjet KOSTT -ENTSO-E paraqet një çështje bllokimi për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike dhe integrim në rajon.

Në vazhden e përpjekjeve të saj për të ndihmuar në tejkalimin e kësaj çështje, ENTSO-E do të thërrasë një takim më 25 nëntor 2016, duke ftuar KOSTT dhe EMS me qëllim të gjetjes së një opsioni për vendosjen në funksion të marrëveshjes së koneksionit të vitit 2015 ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E. Mbetet të shihet rezultati i këtij takimi.

Për shkak të mos zbatimit të marrëveshjes për energjinë, KOSTT dhe KEDS akoma nuk kanë qasje në pjesën veriore të Kosovës, e cila është duke përjetuar humbje financiare. Në të njëjtën kohë, Serbia është duke shmangur pagesën e tarifave të KOSTT për shfrytëzimin e linjave të transmisionit të energjisë në Kosovë dhe për shkaktimin e kongestionëve.

### **3. LARGIMI I BARRIKADËS DHE REVITALIZIMI I URËS SË MITROVICËS**

---

Pas më shumë se një viti, më 14 gusht 2016, zbatimi i marrëveshjes filloi me largimin e barrikadës nga ura e Mitrovicës, përderisa revitalizimi i saj është në progres dhe pritet të finalizohet më 20 janar 2017.

Kjo urë që ka qenë një urë e ndarjes që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999 më në fund

do të jetë një urë që do të shërbejë për lidhjen e personave dhe do të mundësojë lëvizjen e plotë të lirë të personave dhe automjeteve, sikurse çdo urë tjetër në botë. Revitalizimi i urës ka filluar në të njëjtën ditë kur është larguar barrikada, më 14 gusht 2016, dhe punimet janë duke u kryer nga kompania e kontraktuar nga BE-ja.

Ministrja për Dialog Edita Tahiri ka inspektuar dy herë punimet për revitalizim në urën e Mitrovicës, ku vizita e fundit ishte më 11 nëntor 2016, ku ajo vëzhgoi progresin e vazhdueshëm në lidhje me dinamikat e parapara.

Zbatimi i kësaj marrëveshje filloi vetëm pas arritjes së marrëveshjes së re për zbatim në Bruksel, në mes të pushimeve verore, më 5 gusht 2016, pasi që vetëm atëherë, një vit pas arritjes së marrëveshjes për çështjen (25 gusht 2015), Serbia tregoi gatishmërinë për zbatim.

Marrëveshja e datës 25 gusht 2016 parashikoi finalizimin e zbatimit deri në muajin qershor të vitit 2016; megjithatë, kjo nuk u arrit për shkak të mungesës së gatishmërisë së Serbisë. Gjithashtu, marrëveshja e arritur në muajin korrik të vitit 2014 dështoi për disa arsye.

Në të njëjtën kohë, përkatësisht më 29 dhe 30 tetor 2016, janë larguar edhe dy barrikadat tjera të mbetura në Mitrovicën veriore falë iniciativës së qytetarëve nga komuniteti Serb dhe Shqiptar.

Vlen të përmendet që nuk ka më barrikada në pjesën veriore të Kosovës, më shumë se 20 prej tyre sa kanë qenë tashmë janë larguar falë Dialogut të Brukselit dhe lëvizja e lirë e personave dhe automjeteve është normalizuar, së bashku me përmirësimin e jashtëzakonshëm në fushën e sigurisë. Në bazë të marrëveshjes së Brukselit të datës 25 gusht 2015, largimi i barrikadës dhe revitalizimi i urës së Mitrovicës duhej të ishte përfunduar jo më vonë se në muajin qershor të vitit 2016; megjithatë, Serbia refuzoi bashkëpunimin për zbatim.

Në anën tjetër, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka vazhduar të punojë për nënshkrimin e MM i cili do të vendoste respektimin e sundimit të ligjit në fushën e planifikimit urban dhe do të konfirmonte zonat kadastrale të fshatrave Suhodoll dhe Kroi i Vitakut. Megjithatë, kryetari i Mitrovicës Veriore (Rakic) deri më tani nuk ka treguar gatishmërinë të bashkëpunojë në këtë çështje, ndërsa kryetari i Mitrovicës Jugore (Bahtiri) ka qenë bashkëpunues dhe i gatshëm për nënshkrim. Grupi punues për këtë çështje përfshinë gjithashtu Ministrinë për Dialog, Zyrën e BE-së në Kosovë dhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së. Një numër i takimeve është mbajtur nën patronazhin e MMPH-së gjatë muajit shtator dhe tetor në mënyrë që të përfundohet MM, ku në njërin prej këtyre takimeve kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e BE-së nga Brukseli. Përfundimi i përbashkët ishte se MMPH-ja është duke bërë më të mirën për arritjen e MM; mosbashkëpunimi nga kryetari i Mitrovicës Veriore mbetet një shqetësim.

#### **4. PËRMIRËSIME NË FUNKSIONIMIN E KATËR KOMUNAVE VERIORE NË KOSOVË**

---

Në këtë periudhë raportuese është arritur progres sa i përket funksionimit ligjor të katër komunave veriore.

##### **Progresi kryesor ndërlidhet me këto fusha:**

Organet administrative komunale janë duke punuar më mirë në kontekstin e ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët, në përputhje me ligjin e Kosovës.

Për dallim nga dy vitet e kaluara, kuvendet e komunave veriore kanë miratuar buxhetet vjetore për vitin 2017 në harmoni me ligjin e Kosovës, përkatësisht në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Katër komunat veriore gjithashtu kanë përmbushur obligimin ligjor për të raportuar në lidhje me aktivitetet e tyre tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si ministria përgjegjëse për qeverisjen komunale.

Ata marrin pjesë në procesin e reformave të administratës publike, e cila është një nga reformat kryesore të BE-së për Kosovën. Ata janë duke treguar angazhim në disa fusha të agjendës Evropiane, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, konsultimet dhe qasjen në dokumentet publike, Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë, Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturisë, si dhe themelimin e qendrave për shërbimin me qytetarët.

Funksionimi i organeve lokale administrative është përmirësuar. Siç është raportuar, janë mbajtur 41 takime dhe janë miratuar 36 akte, ku nga të cilat 5 janë rregullore komunale dhe 31 vendime në komunat e Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit.

Gjithashtu janë shënuar përmirësime në kuadër të ofrimit të shërbimit për qytetarët. Sistemi financiar, sistemi kadastral dhe sistemi i regjistrimit civil është operativ në komunën e Mitrovicës Veriore. Në tri komunat tjera këto çështje janë të pazgjidhura.

Në Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, institucionet qendrore janë duke mbajtur takime të rregullta dhe kanë realizuar trajnime të veçanta për zyrtarët përkatës të këtyre komunave sa i përket instalimit dhe operimit të këtyre sistemeve. Është planifikuar instalimi dhe funksionalizimi i këtyre sistemeve brenda këtij viti në të gjitha komunat veriore; megjithatë, për këtë nevojitet më shumë vullnet politik.

Sistemi i Free Balance tashmë është funksional në komunën e Mitrovicës Veriore dhe është instaluar në komunën e Zubin Potokut dhe stafi përkatës është trajnuar mbi përdorimin e këtij sistemi. Komuna e Leposaviqit dhe Zveçanit kanë filluar instalimin e këtij sistemi që nga muaji tetor i vitit 2016.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë ka instaluar sistemin e teleprezencës në komunën e Mitrovicës Veriore, ndërsa gjatë muajit shtator të vitit 2016 është rishpallur tenderi publik për ofrimin dhe instalimin e pajisjes së teleprezencës në komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut.

### **Fushat në të cilat akoma nuk ka progres janë si në vijim:**

Katër komunat veriore akoma janë duke operuar pa simbole zyrtare, stemave, vulave, etj.

Stafi administrativ akoma nuk është integruar në tri komuna, përkatësisht në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Vetëm komuna e Mitrovicës Veriore ka qenë e suksesshme në integrimin e stafit administrativ.

Sistemi i arsimit, përfshirë Universitetin e Mitrovicës Veriore dhe sistemin shëndetësor janë akoma nën sistemin e Serbisë dhe strukturave të tij paralele.

Procedurat e prokurimit nuk zhvillohen në përputhje me ligjin e Kosovës.

Zyrat Kadastrale në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq akoma nuk janë integruar në sistemin e Kosovës dhe operojnë nën strukturat paralele të Serbisë.

Shërbimet lokale publike ofrohen kryesisht në bazë të qasjes diskriminuese politike dhe etnike. Shqiptarët dhe Boshnjakët, si dhe qytetarët Serbë që kanë punuar për institucionet e Kosovës që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, ndihen të diskriminuar.

Përpyekja e Agjencisë e Statistikave të Kosovës dhe EUROST për organizimin e regjistrimit të popullsisë në vitin 2016 në katër komunat veriore ka dështuar për shkak të refuzimit nga autoritetet lokale që janë ndikuar në mënyrë negative nga Serbia. Këto komuna refuzuan të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011. Marrëveshja e brendshme për realizimin e regjistrimit të popullsisë është arritur në një takim të mbajtur në fillim të vitit 2014 ndërmjet zëvendëskryeminstres së atëhershme, Edita Tahiri, dhe kryetarëve të zgjedhur të këtyre komunave, me praninë e Zyrës së BE-së dhe Ambasadës së SHBA-së në Kosovë. Kryetarët e komunave u pajtuan për regjistrimin e popullsisë dhe si shkëmbim kërkuan rritjen e numrit të vendeve të rezervuara në kuvendet e dy komunave, përkatësisht Zveçanit dhe Zubin Potokut (katër vende të rezervuara për secilën). Megjithatë, pas udhëzimeve nga Serbia, këta kryetarë të

komunave refuzuan regjistrimin e popullsisë; prandaj, përfshirja e BE-së është shumë e rëndësishme për zgjidhjen e kësaj çështje duke pasur parasysh rëndësinë e shumëfishtë të regjistrimit të popullsisë në planet dhe zhvillimin e komunave.

Mbetet akoma shumë për t'u bërë në mënyrë që këto komuna të funksionojnë plotësisht në përputhje me ligjin e Kosovës, edhe pse progresi i përmendur më lartë tregon trende pozitive.

Vonesat dhe dështimet kryesore kanë ndodhur për shkak të ndërhyrjes së Serbisë në të dyja anët, së pari përmes pengimit të strukturave komunale të zgjedhura në mënyrë legale që të respektojnë ligjet e Kosovës dhe së dyti përmes mbështetjes së funksionimit të strukturave paralele ilegale komunale.

Funksionimi i katër komunave veriore (Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit) të zgjedhura në zgjedhjet lokale të Kosovës të mbajtura në vitin 2013 vazhdon të jetë i brishtë në aspektin ligjor.

Këto komuna akoma nuk kryejnë shumicën e detyrave të tyre në përputhje me ligjin e Kosovës, siç kërkohet nga marrëveshja e parë e Brukselit mbi normalizimin e marrëdhënieve. Arsyeja kryesore për këto dështime është ndërhyrja e Serbisë në dy mënyra, përkatësisht përmes pengimit të strukturave komunale të zgjedhura në mënyrë legale që të respektojnë ligjin e Kosovës dhe përmes mbështetjes së funksionimit paralel të strukturave ilegale komunale.

## **5. STRUKTURAT PARALELE TË SERBISË NË KOSOVË - AKOMA NUK JANË SHPËRBËRË**

Serbia akoma po përkrahë strukturat e saj paralele në Kosovë, duke shkelur kështu marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve të datës 19 prill 2013. Strukturat paralele janë të pranishme në shumë fusha, përfshirë arsimin, shëndetësinë, administratën komunale, kulturën, etj.

Zyrtarët serbë flasin hapur për angazhimin e Qeverisë së Serbisë në fuqizimin e mëtejshëm të këtyre strukturave ilegale në Kosovë. Më 8 nëntor 2016, Ministri i Kulturës i Serbisë, Vukosavljević, foli hapur për gazetën Serbe "Jedinstvo" në lidhje me "fuqizimin e institucioneve kulturore në Kosovë".

Në këtë periudhë raportuese janë marrë një numër i vendimeve nga Qeveria e Serbisë sa i përket strukturave paralele në Kosovë:

Më 9 nëntor 2016, Qeveria e Serbisë vendosi të harmonizojë aktivitetet e të ashtuquajturës ndërmarrje publike për zhvillimin dhe avancimin e informacioneve nëpërmjet mediave elektronike në gjuhën serbe në Kosovë të quajtur "Mreža- Most", Beograd, aktivitetet kryesore të së cilës do të jenë zhvillimi dhe promovimi i informacioneve nëpërmjet medias elektronike

në gjuhën Serbe në Kosovë.

Më 9 nëntor 2016, Qeveria Serbe vendosi të emërojë një kryesues dhe anëtarët e Bordit të ansamblit të ashtuquajtur Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore të Kosovës “Vena”, ku si kryesuese është emëruar Brankica Kostic, Drejtoreshë e Bibliotekës Paralele të Graçanicës. Këta ishin anëtarët: Pavle Vasić nga Graçanica, Kosovë, Jelena Mirkovic, gazetare në Televizionin Most, Gordana Jovanović, punon në OSBE si përkthyes dhe Dalibor Popović, valltar dhe këngëtar në këtë ansambël. Në të njëjtën ditë, Qeveria e Serbisë vendosi të shkarkojë të ashtuquajturin Shef i Distriktit Administrativ të Mitrovicës së Kosovës në Mitrovicë, Radenko Nedelković.

Për më shumë informacione në lidhje me problemin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, ju lutemi shihni Raportin e Kosovës mbi Gjendjen Aktuale për periudhën janar – qershor 2016, i cili mund të gjendet në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_State\\_of\\_Play\\_in\\_the\\_Brussels\\_Dialogue\\_15\\_June\\_2016-signed.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_State_of_Play_in_the_Brussels_Dialogue_15_June_2016-signed.pdf)

## **6. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË**

---

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjes për asociacionin, siç e kemi paraqitur në të gjitha marrëveshjet tjera.

Marrëveshja për Asociacionin e arritur më 25 gusht 2015 është në përputhje me ligjin dhe kushtetutën e Kosovës; Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë një shtresë e tretë e qeverisjes në Kosovë. Pika 2 e marrëveshjes është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; prandaj statuti i Asociacionit do të jetë në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 26 dhjetor 2016.

Kosova e njeh Asociacionin si strukturë ligjore të ngjashme me asociacionin ekzistues në Kosovë që do t'i ndihmojë komunat që të koordinojnë më mirë çështjet lokale, si dhe të ndihmojnë në ri-integrimin e komunitetit Serb në sistemin e Kosovës.

Duke e pasur parasysh që barrkada tashmë është larguar nga Ura e Mitrovicës, procesi i hartimit të statudit të Asociacionit do të fillojë në Prishtinë menjëherë pasi Kosova të merr kodin telefonik nga ITU, që pritet të ndodhë më 15 dhjetor 2016. Ky proces i hartimit të statudit do realizohet në mënyrë të sinkronizuar me procesin e largimit të strukturave të mbetura paralele Serbe në Kosovë, për të cilat grupi punues trepalësh do të punojë në Bruksel.

Për të treguar zotimin serioz për zbatimin e Asociacionit, në qershor të këtij viti, Kosova ka bërë një hap përpara duke ndryshuar përbërjen e ekipit menaxhues të themeluar në vitin 2013, duke emëruar dy anëtarë të rinj pasi që anëtarët e mëhershëm kanë filluar punë të tjera. Tani, ekipi

menaxhues ka më shumë një karakter përfaqësues, duke pasur parasysh që përbërja fillestare ka reflektuar vetëm katër komunat veriore.

Ka pasur disa ngjarje të papërshtatshme në lidhje me anëtarët e ekipit menaxhues. Qeveria e Serbisë i ka manipuluar duke i sjellë në Bruksel në përpjekje për aranzhimin e disa takimeve me zyrtarët e BE-së/EEAS, më 8 shtator 2016. Në mesin e tyre kishte disa ministra Kosovar nga komuniteti Serb. Zyrtarët e BE-së nuk i kanë pranuar ata në takim dhe madje nuk i kanë lejuar të hyjnë në ndërtesën e Bashkimit Evropian pasi që takime të tilla ishin konsideruar si jo në përputhje me marrëveshjen.

Qeveria e Kosovës konfirmon që themelimi i Asociacionit me vendimin e qeverisë kushtëzohet me shpërbërjen e plotë të strukturave të mbetura paralele Serbe në Kosovë. Asociacioni nuk mund të themelohet përderisa ekziston situata paradoksale e funksionimit legal dhe ilegal të komunave në Kosovë, pasi që mund të rezultojë që të shërbehen të dyja strukturat dhe të përfundohet në shkëlqen e ligjit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ia ka bërë të njohur këtë qëndrim zyrtarëve të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtar.

## **7. “MBROJTJA CIVILE” – SHPËRBËRJA DHE INTEGRIMI I PERSONELIT NË INSTITUCIONET E KOSOVËS**

---

Zbatimi i kësaj marrëveshje pothuajse është përfunduar. Struktura e ashtuquajtur “Mbrojtja Civile” është mbyllur, ndërsa anëtarët (483) e saj të mëhershëm janë integruar/punësuar në institucionet civile të Kosovës. Këta persona janë punësuar nga 22 ministri dhe agjenci nëpërmjet procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes në bazë të ligjit të Kosovës. Të gjithë kanë marrë përshkrimet e punës dhe kanë nënshkruar kontratat e punës me Qeverinë e Kosovës si nëpunës civil. Kosova ka përfunduar seminarin për ri-integrimin institucional në bashkëpunim me OSBE dhe IKAP. Kontratat për 433 punëtorë janë nënshkruar në janar të vitit 2016 dhe ata janë duke marrë paga, ndërsa 50 kontrata janë nënshkruar në gusht të vitit 2016, ku 11 prej tyre nuk janë të përfshirë akoma në listën e pagave. Së shpejti Qeveria do të lëshojë një vendim administrativ dhe ata do të përfshihen në listën e pagave në përputhje me kontratat.

Në këtë fazë, Kosova është në proces të finalizimit të objekteve në katër komunat veriore në mënyrë që të akomodojë hapësirën e nevojshme punuese për ministrinë dhe agjencitë që kanë punësuar këta persona. Sipas Ministrisë së Administratës Publike, e cila është përgjegjëse për realizimin e këtij projekti, zyrat do të jenë gati deri në mesin e muajit dhjetor dhe më në fund punëtorët do të fillojnë punën e tyre. Secila ministri dhe agjenci që ka punësuar këta persona do të koordinojë në mënyrë të duhur procesin e punës në bazë të programeve të tyre dhe përshkrimet e punës së punëtorëve. Ministria e Administratës Publike ka marrë me qira tri ndërtesa në komunat veriore për të themeluar zyrat për personelin e integruar. Rinovimet kanë filluar dhe pritet të jenë gati gjatë muajit dhjetor të vitit 2016.



Dorëzimi i objekteve të shfrytëzuara nga 'MC' e mëparshme tek institucionet e Kosovës nuk është bërë akoma. Pas dorëzimit, Qeveria e Kosovës do t'i vendos në dispozicion të komunave veriore me qëllim të akomodimit më të mirë të nevojave të tyre.

Përderisa Kosova ka shënuar progres në zbatimin e kësaj marrëveshje, Serbia nuk e ka njoftuar BE-në se ka ndërprerë kontratat e punës dhe pagat. Megjithatë, Serbia nuk ka arritur të shpërbëjë strukturën e 'MC' në aspektin e rregullimit ligjor, prandaj shpërbërja e plotë e 'MC' mund të ndodhë.

Mbyllja e "Mbrojtjes Civile" ka pasur ndikim pozitiv në gjendjen e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, e cila falë marrëveshjeve të Brukselit është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e viteve.

## **8. THEMELIMI I ZYRAVE TË AGJENCISË PËR REGJISTRIM CIVIL DHE ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE NË KOMUNAT VERIORE**

---

### **Zyrat për Regjistrim Civil**

Progres i rëndësishëm është arritur në integrimin e tridhjetë e dy (32) punonjësve të personelit administrativ të ish-policisë në zyrat e Agjencisë së Regjistrimit Civil në pjesën veriore. Procesi i rekrutimit dhe trajnimit, si dhe nënshkrimi i kontratave është kryer nga Agjencia për Regjistrim Civil e Kosovës (ARCK). Më 1 shtator 2016, ata janë futur në sistemin e pagave të Kosovës, respektivisht në buxhetin e MPB-së, dhe të gjithë zyrtarët janë pajisur me letërnjoftime. Këta zyrtarë do të lëshojnë dokumente shtetërore, të tilla si pasaportat dhe letërnjoftimet.

Progres i mirë është bërë në krijimin e hapësirës për punë për zyrat e ARC-së. Në tri komuna, përkatësisht në Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore, çështja e zyrave është zgjidhur dhe ato i përmbushin të gjitha kërkesat për të funksionuar siç duhet. Në Mitrovicën Veriore, zyra do të vendoset në zyrën e Regjistrimit Civil - Qendra për lëshimin e dokumenteve administrative - në Lagjen e Boshnjakëve, në Leposaviq zyra do të jetë në Stacionin Policor, dhe në Zubin Potok zyra do të jetë në ndërtesën e komunës. Në Zveçan, kjo është arritur në bazë të një marrëveshje të arritur me pronarin e një shtëpie private, dhe së shpejti pritet nënshkrimi i marrëveshjes, dhe kjo ndërtesë do të funksionalizohet si një zyrë. Arsyeja e kontraktimit të një ndërtese private është për shkak se nuk ka hapësirë në ambientet publike.

Në lidhje me shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit janë në fazën e finalizimit të të gjithë projektit dhe javën e ardhshme kjo çështje do të përfundojë. Inventari i nevojshëm për punë në këto zyra është kompletuar nga MPB-ja me mbështetjen e misionit të EULEX-it në Kosovë.

## Zyrat e Gjendjes Civile

Çështja e integritit të tridhjetë e nëntë (39) personave të ish-personelit administrativ të zyrtarëve të MUP-it në Zyrat e Gjendjes Civile në katër komunat veriore ende nuk është zgjidhur për shkak se Qeveria duhet të marrë vendim për vlefshmërinë e dokumenteve të vjetra që do t'ua mundësojnë qytetarëve të pajisen me dokumente shtetërore të Kosovës. Këta persona janë qytetarë të komunitetit serb të Kosovës të cilët janë në Regjistrin Civil të Kosovës, por që deri më tani kanë refuzuar t'i pranojnë dokumentet e shtetit të Kosovës, dhe vetëm në kohët e fundit kanë shfaqur një interesim në rritje për t'i pranuar ato.

Projekt-vendimi për vlefshmërinë e dokumenteve të vjetra është hartuar në shtator dhe i është prezantuar Qeverisë për aprovim. Përveç kësaj, më 30 shtator 2016, Ministria e Punëve të Brendshme ka dorëzuar te Qeveria një memorandum shpjegues në lidhje me këtë vendim, ashtu siç është kërkuar. Qeveria është ende në fazën e shqyrtimit të tij në mënyrë që të dalë me një aprovim.

Hapat e ardhshëm që do të ndërmerren janë procesi i rekrutimit, trajnimi, nënshkrimi i kontratave të punës nga MAPL, ndërsa hapësirat e zyrës do të jenë në hapësirat e Komunës.

Sa i përket marrëveshjes, fillimisht ishin dyzet e pesë (45) persona që duhej të integroheshin, por numri përfundimtar i shpallur tani është 39. Kjo është konfirmuar nga përfaqësues të sindikatës të personelit administrativ të ish-punonjësve të MUP-it, se tre (3) persona kanë dalë në pension dhe tre (3) persona kanë refuzuar të integrohen në institucionet e Kosovës.

ARC dhe zyrat e gjendjes civile do t'i pajisin qytetarët në katër komunat veriore me dokumente shtetërore të Kosovës dhe dokumente të gjendjes civile. Kjo ka një rëndësi të madhe në kontekstin e përpjekjeve tona për ta përfunduar me sukses procesin e integritit të komunitetit serb në institucionet e Kosovës.

## 9. DREJTËSIA

---

Sa i përket drejtësisë, është arritur progres i jashtëzakonshëm dhe ne jemi gati për ta finalizuar zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit të datës 19 prill 2013 në lidhje me drejtësinë, një numër të konkluzioneve të vitit 2013 si dhe marrëveshjen për drejtësinë, të arritur më 9 shkurt 2015. Në bazë të marrëveshjes, një gjykatë themelore dhe një zyre prokuroriale do të themelohen në rajonin e Mitrovicës, duke mbuluar shtatë komunat, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Kosova ka përfunduar integrimin/rekrutimin e personelit gjyqësor serb, 45 gjyqtarë, 14 prokurorë dhe 141 anëtarë të personelit administrativ. Ka përfunduar provimi i jurisprudencës për 6 kandidatë. Nënshkrimi i deklaratave nga personeli integruar gjyqësor do të fillojë së shpejti.

Strukturat paralele të drejtësisë janë mbyllur *de facto* që nga fundi i vitit 2013, siç parashikohet me marrëveshjet e Brukselit. Mbyllja e këtyre strukturave paralele *de jure* duhet të bëhet nga pala serbe, e cila duhet ta ndërpresë kontratat e punës dhe pagat për këta persona, dhe t'i shpërbëjë strukturat paralele të drejtësisë, duke rregulluar ligjet e saj përkatëse.

Rekrutimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës serb ka përfunduar. Në total, nga dy fazat e procesit të rekrutimit në vitin 2015 dhe 2016, u përzgjedhën 45 gjyqtarë, 14 prokurorë dhe 141 punonjës të personelit administrativ. Nga 141 persona, 108 do të shërbejnë si personel gjyqësor administrativ dhe 33 persona si personel prokurorial administrativ.

Ka pasur hapje të vendeve të punës për 48 pozita për gjyqtarë, 15 pozita për prokurorë dhe 149 pozita për personel administrativ, në përputhje me Marrëveshjen për Drejtësi të datës 9 shkurt 2015.

Vendet e lira nga procesi i integritetit do të plotësohen përmes një procedure të rregullt sipas ligjeve të Kosovës për drejtësi në bazë të marrëveshjes së datës 9 shkurt 2015.

Provimi i jurisprudencës, si një komponent i rëndësishëm i zbatimit të marrëveshjes për drejtësi, ka përfunduar me sukses. Bazuar në procedurat juridike të përcaktuara me ligjin përkatës të Kosovës, 6 kandidatë serbë i janë nënshtruar këtij procesi në emër të integritetit në një sistem unik të drejtësisë në Kosovë. Ministria e Drejtësisë ka publikuar një shpallje publike për mbajtjen e Provimit të Jurisprudencës.

Çështja e buxhetit është zgjidhur sa i përket qirasë së objektit për zyrën e prokurorisë në Mitrovicë (vendi, Lagjja e Boshnjakëve). Ndërtesa për Këshillin Prokurorial të Kosovës është e gatshme për fillimin e punës.

Çështjet që lidhen me Gjykatën e Apelit/Divizioni i Apelit në Mitrovicë janë duke u finalizuar. Vendndodhja fizike e Divizionit Apelit është në ndërtesën shtesë të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sipas marrëveshjes.

Procesi i ankesave për personelin administrativ është duke vazhduar. Njoftimi për ankesa për kandidatët e pazgjedhur u është dërguar atyre nga KGJK-ja, më 23 nëntor 2016.

Rregullorja, përkatësisht Shtojca për Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave është hartuar, ndërsa procesi i miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të fillojë në ditët në vijim. Në dhjetor do të bëhet emërimi nga Presidenti në përputhje me ligjin e Kosovës. Lista e kandidatëve të aprovuar nga KGJK dhe KPK do të dërgohet te Presidenti i Kosovës për emërimin si gjyqtarë dhe prokurorë. Kandidatët do të betohen dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të

besnikërisë në praninë e Presidentit të Kosovës.

Menjëherë pas emërimit të tyre do të fillojë procesi i emërimit të krerëve të Gjykatës Themelore, Prokurorisë dhe Divizionit të Apelit në përputhje me ligjin e Kosovës.

Në anën tjetër, Serbia duhet t'i përmbushë detyrimet e saj, që nënkupton marrjen e vendimeve të Qeverisë për shfuqizimin e kontratave të punës dhe pagave për ish-gjyqtarët, prokurorët dhe personelin administrativ që dikur punonin në strukturat paralele dhe që tani janë punësuar në institucionet e drejtësisë në Kosovë. Serbia duhet që gjithashtu t'i shpërbëjë strukturat paralele të drejtësisë në Kosovë, të cilat *de facto* kanë pushuar së funksionuari në vitin 2013. Për këtë qëllim, Serbia duhet të bëjë ndryshime ligjore në Ligjin nr. 116/2008 mbi Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorëve.

Zbatimi i marrëveshjes për drejtësi mundëson vendosjen e drejtësisë së unifikuar të Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, e cila për shumë vite ishte e sfiduar nga strukturat paralele. Kjo padyshim do të ndihmojë në normalizimin e situatës në atë pjesë të vendit duke i shërbyer nevojave të qytetarëve për drejtësi.

## **10. ZYRAT NDËRLIDHËSE DHE VIZITAT BILATERALE**

---

Marrëveshja është duke u zbatuar në mënyrë korrekte, por nën minimumin e kushteve për Zyrat Ndërlidhëse (ZN). Nuk është arritur progres në avancimin e rolit të të dy Zyrtarëve Ndërlidhës. Marrëveshja e mëparshme për personel dhe hapësira shtesë nuk është zbatuar ende. Ka të dhënat të pakta në lidhje me takimin e nivelit të lartë mes ZN të Kosovës dhe zyrtarëve të Serbisë.

Simbolet zyrtare të të dy ZN-ve nuk janë pacaktuar ende.

Pavarësisht kushteve minimale, vizita të shumta zyrtare bilaterale janë administruar nga të dy ZN-të në shtetet përkatëse.

Është regjistruar vetëm një rast i shkeljes së lejes në periudhën raportuese. Zyrtari serb z. Marko Gjuriq ka devijuar nga agjenda që ai vetë e ka propozuar - në vend që t'i vizitojë objektet fetare, ai organizoi tubime politike/partiake ku mbajti deklaratë shumë provokuese.

Misioni i Zyrave Ndërlidhëse është që të marrin pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve dhe të adresojnë problemet e përditshme që mund të ndodhin. Zyrat janë ofruar nga delegacionet e BE-së në të dyja vendet. Bashkimi Evropian siguron lehtësim për t'i realizuar këto marrëveshje dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre në përputhje me praktikat më të mira të BE-së. Një vit pas themelimit të tyre, të dyja palët ranë dakord për ta dorëzuar administrimin e kërkesave për vizita zyrtare tek ato.

## 11. TREGTIA E LIRË / DOGANA

---

Tregtia e lirë ndërmjet dy shteteve u mundësua falë njohjes reciproke të vulave doganore në vitin 2011 dhe zbatimi është në nivel të kënaqshëm.

Herë pas here janë vërejtur pengesa në përdorimin e vulave paralele doganore nga Autoritetet Doganore të Beogradit. Shkeljet janë raportuar rregullisht në BE.

Serbia duhet ta respektojë marrëveshjen dhe t'i shpërbëjë strukturat dhe vulat e saja paralele doganore. Organogrami i Administratës Doganore të Serbisë (zyrat doganore) ende e përfshinë Prishtinën si zyrë të saj doganore. Kjo mund të shihet në linkun e mëposhtëm: [www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx](http://www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx). Vulat ilegale përdorin mbishkrimet "Carinarnica Pristina" (Dega Doganore në Prishtinë) dhe është nën është nën Degën Doganore të Nishit në Serbi.

Kjo tregon që Serbia edhe pas pesë vitesh nuk po e respekton plotësisht Marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë të vulave doganore, të arritur më 2 shtator 2011 dhe që, për më tepër, po i shkel rregullat e CEFTA-së, në kuadër të të cilave palët janë pajtuar që të përdorin vulat e konfirmuara për të gjithë anëtarët e CEFTA-së.

## 12. LIRIA E LËVIZJES

---

Gjatë kësaj periudhe, Serbia ka dëmtuar seriozisht lirinë e lëvizjes ndërmjet dy shteteve duke arrestuar dy qytetarë në pikë-kalimin kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nehat Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Policisë Rajonale në Mitrovicë, ishte arrestuar më 29 shtator 2016 dhe ishte mbajtur në paraburgim për më shumë se një muaj në baza arbitrare. Hilmi Kelmendi ishte arrestuar më 28 tetor 2016 dhe ishte liruar pas një jave.

Këto arrestime arbitrare të qytetarëve të Kosovës nga ana e Serbisë nuk kanë qenë vetëm veprime provokuese kundër Kosovës, por ato gjithashtu kanë dëmtuar rëndë besimin e qytetarëve në marrëveshjen e Brukselit për Lirinë e Lëvizjes.

Kosova ka reaguar ashpër ndaj veprimeve të tilla provokuese nga ana e Serbisë, duke i bërë thirrje BE-së që ta lehtësojë zgjidhjen e këtyre problemeve dhe të sigurojë zbatimin e plotë të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes.

Kosova vlerëson se Serbia ka tendenca që ta zgjerojë në mënyrë të paligjshme juridiksionin e saj në çështjet e krimeve të luftës pa asnjë bazë, gjë për të cilën tashmë është përballur me refuzimin

nga Kroacia, dhe Kosova kërkoi nga BE-ja që t'ia tërheqë vëmendjen për këtë çështje serioze që mund të ketë pasoja destabilizuese.

Përveç kësaj, Serbia ende nuk i lejon qytetarët e vendeve të treta të hyjnë në Serbi përmes Kosovës, pavarësisht faktit se Kapitulli i 35-të i BE-së i bën thirrje Serbisë që ta zgjidhë këtë çështje.

Zhvillimi pozitiv është se gjatë periudhës raportuese nuk janë përdorur letërnjoftime ilegale të lëshuara nga strukturat paralele gjatë kalimit të kufirit ndërmjet dy shteteve.

### **13. RECIPROCITETI NË TABELAT E REGJISTRIMIT DHE NDALIMI I TABELAVE TË PËRKOHSHME TË REGJISTRIMIT TË VENDOSURA NË SERBIA**

---

Pas shumë viteve kërkesë nga Kosova për zgjidhjen e çështjes së ndërprerjes së përdorimit unilateral të tabelave të përkohshme (*provoese*) të regjistrimit për mbulimin e tabelave të regjistrimit RKS të Kosovës dhe pas kërcënimeve serioze nga Kosova për masa të reciprocitetit në bazë të së drejtës që del nga Marrëveshja e vitit 2011 mbi Lirinë e Lëvizjes dhe Planin e Veprimit, më në fund kjo çështje është zgjidhur nëpërmjet marrëveshjes së arritur më 14 shtator 2016.

Marrëveshja e njohur si 'Marrëveshjet për përfundimin e zbatimit të Marrëveshjes së Lëvizjes së Lirë të Mallrave të vitit 2011' përcakton reciprocitetin në tabelat e regjistrimit ndërmjet dy shteteve duke filluar nga data 15 nëntor 2016 dhe parasheh ndërprerjen e përdorimit të tabelave ilegale të regjistrimit pas 12 muajve, duke filluar nga data 17 janar 2017 dhe zgjat përdorimin e tabelave të regjistrimit KS për 5 vite. Afati shtyhet për shkak të vonësive të natyrës administrative nga Kosova.

### **14. MIK – MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT DHE NDËRTIMI I OBJEKTEVE TË PËRHERSHME**

---

Zbatimi i marrëveshjes së MIK është i jashtëzakonshëm, duke pasur parasysh bashkëpunimin shumë konstruktiv ndërmjet autoriteteve kufitare të të dyja shteteve.

Faza e dytë e zbatimit që përfshinë ndërtimin e objekteve të përhershme në të gjitha gjashtë pikë-kalimet kufitare është në realizim. Kosova do të ndërtojë tri PKK, përkatësisht në Merdare, Bërnjak dhe Multivodë, ndërsa Serbia do të ndërtojë tri PKK tjera, përkatësisht në Jarinjë, Dheu i Bardhë dhe Muqibabë. Dizajni i objekteve të përhershme është nënshkruar nga të tria palët, përkatësisht Kosova, Serbia dhe BE-ja në shtator të vitit 2014. Dizajni është bërë nga kompania e kontraktuar nga BE-ja SAFEGE, në bashkëpunim të ngushtë me secilën palë.

Sa i përket objekteve të përhershme të MIK, Kosova ka shënuar progres të jashtëzakonshëm në përfundimin e dizajnëve final të projektit në bashkëpunim me BE-në dhe UNOPS si partner implementues. Më 14 shtator 2016, Qeveria e Kosovës ka miratuar dizajnët final të projektit për pikë-kalimet kufitare në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë, të cilat do të ndërtohen nga shteti ynë. Afati i dakorduar për fillimin e punimeve ndërtimore në tri pikë-kalimet kufitare është caktuar për muajin janar të vitit 2017. Ministria për Dialog me institucionet përkatëse qeveritare, zyrën e PSBE në Kosovë dhe UNOPS janë duke punuar në mënyrë intensive mbi këto projekte të financuara nga BE-ja.

Fatkeqësisht, Serbia nuk ka punuar shpejtë në zbatimin e objekteve të përhershme të MIK në tri pikë-kalimet kufitare për të cilat janë partner ndërtues. Në takimin e GP të MIK të mbajtur më 17 nëntor 2016, Serbia ka raportuar disa hapa që kanë ndërmarrë, të cilat tregojnë që ata janë larg përfundimit të dizajnëve final të projektit, edhe pse partneri implementues nga BE-ja, përkatësisht UNOPS, ka treguar gatishmëri për arritjen e progresit.

Dy pikë-kalimet e reja kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të hapen këtë vit. Të dyja palët kanë theksuar punën e bërë në funksionalizimin e plotë të PKK së re, ku Kosova do të ndërtojë PKK Kapia dhe Serbia do të ndërtojë PKK Izvor.

Progres i konsiderueshëm është bërë në zbatimin e SEED (Shkëmbimi Sistemik i të Dhënave Elektronike mbi Doganat).

Zbatimi i Ndhmës së Ndërsjellë Ligjore (NNL) nuk ka qenë i kënaqshëm. Serbia është duke vonuar përgjigjet për kërkesat e Kosovës dhe po e shkel marrëveshjen nëpërmjet përdorimit të vulave multilaterale në kërkesat e Kosovës.

Marrëveshja për MIK dhe Protokolli Teknik është marrëveshja e parë e nënshkruar ndërmjet dy vendeve, e cila mundëson përcaktimin e kufirit ndër-shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ka mundësuar ri-vendosjen e autoriteteve shtetërore Kosovare në dy pikë-kalime kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat gjenden në pjesën veriore të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## **15. BASHKËPUNIMI RAJONAL**

---

Gjatë kësaj periudhe është shënuar një përparim i mirë në lidhje me përfaqësimin e Kosovës në organizata rajonale.

Më 14 qershor 2016, Kosova u bë anëtare me të drejta të plota në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit.

Më 15 korrik 2016, Kosova ka aderuar në Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja (Konventën Apostille).

Më 29 tetor 2016, Prokurori i shtetit të Kosovës u bë anëtarë i Shoqatës Ndërkombëtare të

Prokurorëve.

Më 10 tetor 2016, Kosova zyrtarisht u bë pjesë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ku Delegacioni Parlamentar i Kosovës do të ketë mundësi të marr pjesë në seancat plenare dhe në mbledhjet e organeve tjera të këtij institucioni.

Më 18 tetor 2016, Oda Ekonomike e Kosovës u bë anëtare e plotë e Shoqatës Evropiane të Odave Ekonomike (Odave të Evropës).

Kosova ka marrë pjesë në takime të shumta ndërkombëtare dhe rajonale të nivelit të lartë, në mënyrë të barabartë me shtetet e tjera. Këtu janë disa nga të dhënat: më 12 nëntor në qytetin e Zagrebit, delegacioni i Kosovës ka marrë pjesë në takimin e Kartës së Adriatikut A-5 në lidhje me çështjet e sigurisë; Delegacioni i Kosovës nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë më 23 tetor 2016, trajnim ky i organizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat, në të cilin shteti i Kosovës u paraqit pa fusnotë dhe i barabartë me shtetet e tjera; më 14 tetor 2016, Oda Ekonomike e Kosovës ka marrë pjesë për herë të parë si anëtare e barabartë me të drejtë vote në Edicionin vjetor të Parlamentit Evropian të Ndërmarrësve; Më 11 shtator 2016, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi ishte pjesë e panelit të Forumit Ekonomik Ndërkombëtar në Toronto, ku kishte të pranishëm delegatë nga më shumë se 40 shtete; më 27 shtator 2016, Sindikata e Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Evropës ka futur Shoqatën Sindikale të Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Kosovës në hartën e ngjarjeve të aviacionit në Evropë.

Në përgjithësi, sporti i Kosovës ka arritur sukses të madh gjatë kësaj periudhe. Më 11 nëntor 2016, Kosova u bë kampione e Evropës për garuesit nën moshën 23 vjeç në xhudo në kategorinë 52 kg. Kosova fitoi medaljen e artë Olimpikë në xhudo në kategorinë 52kg në konkurrencën e femrave. Më 23 shtator, Kosova fitoi medaljen e bronzit në "Grand Prix" të mbajtur në Zagreb, në xhudo, kategoria deri në 48kg në konkurrencën e femrave. Federata e Futbollit e Kosovës për herë të parë këtë vit po luan në ndeshjet kualifikuese për Kupën e Botës që do të zhvillohet në Rusi në vitin 2018.

Shteti i Serbisë po vazhdon të krijojë pengesa në procesin e anëtarësimit të Kosovës. Rastet e evidentuara siç janë në "Euro Geo Surveys", ku më 10-15 tetor në Lubjanë u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Organizatës, nën ndikimin e delegacionit Serb, ka futur në agjendë kërkesën për heqjen e shtetit të Kosovës. Siç dihet nga periudhat e mëhershme, Serbia vazhdon me fushatat kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, dhe paraqet pengesa brenda Federatës Botërore të Volejbollit, ku Kosova tashmë është anëtare.

Gjithashtu paraqet pengesa për delegacionet e Kosovës në pjesëmarrjen e tyre, dhe më 25 tetor 2016, Serbia i kërkoi Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private të refuzojë pjesëmarrjen e delegacionit të Kosovës në forumin e ekspertëve të njohur si Komisioni i Posaçëm, në bazë të Konventës Apostille, pavarësisht faktit që më 15 korrik 2016, Kosova ka aderuar në Konventën Apostille. Në mbledhjet e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, Serbia dërgoi një shkresë verbale në të cilën ajo deklaroi që kjo gjë nuk



nënkupton njohje dhe nuk e paragjykon statusin e Republikës së Kosovës. Më 13 tetor 2016, Serbia i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës duke kundërshtuar pjesëmarrjen e delegacionit të Kosovës në Konferencën e 11 tetorit 2016 për fillimin e Komentarit të katërt tematik mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, të organizuar nga Komiteti Këshillues. Më 26 shtator 2016, një anëtar i Bordit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës u arrestua në Aeroportin e Beogradit dhe nuk u lejua të marrë pjesë në mbledhjen e autoriteteve rajonale. Personi në fjalë u mbajt i arrestuar në Beograd me arsyetimin se dokumentet e Kosovës nuk janë të vlefshme. Prezantimi i Kosovës nën Rezolutën 1244 në nismën ministrore të Procesit të Pragës e cila u mbajt në Bratislavë të Sllovakisë më 21 shtator 2016, e detyroi Ministrin e Punëve të Brendshme të Kosovës të braktisë këtë konferencë.

Marrëveshja parasheh konfirmimin e të dyja palëve për përkushtimin e tyre për bashkëpunim rajonal efektiv, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues. Kosova merr pjesë, flet dhe nënshkruan si e pavarur në takimet rajonale ku emërtimi Kosovë\* është i vetmi që do të përdoret.

## **16. FONDI ZHVILLIMOR**

---

Fondi Zhvillimor i Kosovës për komunat veriore ka pranuar 11 milionë euro nga të hyrat e mbledhura në Jarinjë dhe Bërnjak, në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore të vitit 2013.

Bordi Drejtues i Fondit Zhvillimor ka ndarë tetë (8) milionë euro për projektet që do të financohen nga ky fond në katër komunat e veriut.

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës tashmë ka filluar auditimin e të gjitha projekteve të financuara nga ky fond.

Fondi Zhvillimor është themeluar për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, dhe për të mirën e popullatës lokale në komunën e Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Përdorimi i Fondit përcaktohet nga Bordi Drejtues i përbërë nga Shefi i zyrës së BE-së, Ministri i Kosovës për Financa dhe një përfaqësues i komunitetit Serb.

## **17. MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE NË DY PIKË-KALIMET KUFITARE TË VERIUT**

---

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është duke shkuar shumë mirë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është identifikuar ndonjë pengesë.

Të hyrat e mbledhura në PKK-të në Jarinë dhe Bërnjak transferohen në një llogari bankare të caktuar nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, në një bankë komerciale të

licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Të hyrat e mbledhura nga kompanitë e biznesit në pjesën veriore nga këto dy porta kufitare janë të destinuara të përdoren për financimin e projekteve të komunave në kuadër të fondit zhvillimor.

## **18. DIPLOMAT DHE KADASTRI**

---

Marrëveshjet e diplomave dhe kadastrit i kemi përfshirë në të njëjtin seksion vetëm për qëllim që të theksojmë se këto dy marrëveshje të arritura janë në pritje të zbatimit që nga viti 2011. Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave është bllokuar nga Serbia deri në janar të vitit 2016, kur u arrit një marrëveshje për rrugëdalje me një fushëveprim të zgjeruar e cila ka përfshirë diplomat e të gjitha niveleve të arsimit, dhe përgatitjet për zbatim janë në proces e sipër. Marrëveshja për kthimin e dokumenteve kadastrale nga Serbia në Kosovë është bllokuar nga Kosova për shkak të vonesave në miratimin e Ligjit për Agjencinë Teknike për Krahasimin dhe Verifikimin e Dokumenteve që kthehen nga Serbia. Kosova ka miratuar këtë ligj në prill të këtij viti dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar kushtetutshmërinë e saj. Procesi i zbatimit i të dy marrëveshjeve do të fillojë së shpejti.

## **19. SIGURIMI I AUTOMJETEVE**

---

Zbatimi i marrëveshjes ka qenë i kënaqshëm. Ky zbatim filloi më 12 gusht 2015 pas më shumë se tre vite negociatash. Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është në procesin e identifikimit të Korrespondentit.

Kosova konsideron se me një Byro Kosovare të Sigurimit (BKS) që bashkëpunon në këtë marrëveshje fqinjësore në frymën Evropiane, do të përparojë drejt anëtarësimit në Kartonin e Gjelbër. Këshilli Ndërkombëtar i Byrove (KiB) i cili ishte lehtësues i kësaj marrëveshje së bashku me BE-në duhet të sigurojë pranimin e Kosovës në Kartonin e Gjelbër, ndërsa në ndërkohë ajo duhet të hapë pikat e shitjes së kartonëve të gjelbër Evropian në Kosovë.

---

***Për më shumë informata mbi këtë proces, marrëveshjet dhe raportet e mëparshme periodike, ju lutemi vizitoni faqen zyrtare të Qeverisë së Kosovës: <http://www.kryeministriks.net/?page=2,252>***

## *Lista e shkurtesave*

---

ADR- Marrëveshja evropiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme  
ASYCUDA - Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore  
PKK - Pikë-Kalim Kufitar  
KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës  
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë  
KiB - Këshilli i Byrove/Organizata Menaxhuese e Sistemit të Kartonit të Gjellbër dhe Direktivave të Sigurimit të mjeteve motorike  
MC - e ashtuquajtura 'Mbrojtja Civile'  
ÇPF - Certifikata e Produkteve Farmaceutike  
ARC - Agjencia për Regjistrim Civil e Kosovës  
LRC-Libri i Regjistrimit Civil  
DRC - Këshilli Danez për Refugjatë  
EEAS - Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm  
EED - Dokument për Hyrje/Dalje  
EMS - Operatori Serb i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut  
ENTSO - Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike  
ZRRE- Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës  
BE - Bashkimi Evropian  
EUA - Asociacioni Evropian i Universiteteve  
EUA - Asociacioni Evropian i Universiteteve  
EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë  
PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian  
FBK - Federata e Basketbollit të Kosovës  
FIBA - Federata Ndërkombëtare e Basketbollit  
FIFA - Fédération Internationale de Football Association  
MLL- Marrëveshja për Lëvizje të Lirë  
QK - Qeveria e Republikës së Kosovës  
PL - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë  
MIK - Menaxhimi i Integruar i Kufirit  
GI - Grupi Implementues  
IPA - Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-anëtarësimit  
ITU - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit  
KEDS - Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike  
KESCO - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A  
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
AKPPM - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale  
KOSTT - Operatori Kosovar i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

PK - Policia e Kosovës  
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës  
AKKVP- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës  
AKKVP- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës  
ZN - Zyrtari Ndërlidhës  
MARRI - Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë  
MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës  
MMPH -Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës  
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës  
NNJ - Ndihma e Ndërsjellë Juridike  
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Kosovës  
ZAMV - Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore  
MM - Memorandum i Mirëkuptimit  
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
KM - Kryeministri  
ARKEP- Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës  
RKS - Republika e Kosovës  
SEECF - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore  
SEED - Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizës  
NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme  
SPARK - Organizatë holandeze jo-qeveritare  
TIG - Grupi Trepalësh për Implementim  
TPL - Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj palës së tretë  
OST - Operatori i Sistemit të Transmisionit  
UEFA- Unioni i Federatave Evropiane të Futbollit  
UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë, dhe Kulturë  
UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
UNOPS - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve